

FINANCA

Buletini Maja | SHKURT 2026



MINISTRIA E FINANCËVE TRANSFERON RRETH 167 MILIONË EURO NË FONDIN E VEÇANTË TË PENSIONEVE

Të gjitha fondet buxhetore që nuk u shpenzuan nga ministrinë dhe institucionet publike gjatë vitit 2025 tashmë janë transferuar në Fondin e Veçantë të Pensioneve. Shuma përkatëse është rreth 167 milionë euro, të depozituara tashmë në Llogarinë Speciale të Fondit të Pensioneve pranë Bankës së Shqipërisë. Transferimi i këtyre fondeve përfaqëson një premtim të mbajtur dhe një angazhim të qartë për të përmirësuar

sistemin e pensioneve, duke siguruar stabilitet afatgjatë dhe menaxhim të përgjegjshëm të financave publike. Reforma e Pensioneve do të vijojë të zbatohet me vendosmëri, me qëllim ndërtimin e një sistemi më të drejtë, më të qëndrueshëm dhe më të besueshëm për çdo qytetar. Transferimi i këtyre fondeve buxhetore është kryer në zbatim të Aktit Normativ Nr. 11, datë 19.12.2025, si dhe në përputhje me kuadrin ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor. Ky është një hap konkret në drejtim të forcimit të qëndrueshmërisë financiare të sistemit të pensioneve dhe garantimit të një mbështetjeje më të drejtë dhe më të sigurt për pensionistët.

► LEXO MË SHUMË

NXITJA E PËRDORIMIT TË GARANCISË SOVRANE PËR BUJQËSINË, MINISTRIA E FINANCËVE ORGANIZON NJË TAKIM ME BANKAT TREGTARE

Ministria e Financave organizoi një takim të zgjeruar në nivel të lartë institucional, në vijim të dialogut të vazhdueshëm mbi përdorimin e Skemës së Garancisë Sovrane për sektorin bujqësor. Takimi u zhvillua nën drejtimin e Ministrit të Financave, me pjesëmarrjen e Guvernatorit të BSH; Ministrin të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në vend dhe përfaqësuesve nga Shoqata Shqiptare e Bankave. Qëllimi i këtij takimi ishte

vlerësimi i progresit të deritanishëm në zbatimin e instrumenteve të financimit, identifikimi i çështjeve që ndikojnë në transmetimin efektiv të kreditimit drejt ekonomisë reale, si dhe adresimi i sfidave të evidentuara nga sektori bankar dhe subjektet përfituese. Ministri Petrit Malaj theksoi se sektori bujqësor mbetet një prioritet strategjik i Qeverisë së Shqipërisë. Me afrimin e integritetit të ekonomisë shqiptare në tregun e përbashkët evropian është e nevojshme që biznesi shqiptar të përmirësojë produktivitetin dhe të rrisë vlerën e shtuar përgjatë të gjithë zinxhirit prodhues. Si rrjedhojë, Skema e Garancisë Sovrane duhet parë si një mundësi që përshpejton pikërisht këtë proces sa jetik aq edhe imediat.

► LEXO MË SHUMË



PERFORMA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 12 MUJORE 2025

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Dhjetor 2025 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 12 muajore 2025, arritën në rreth 754.6 miliardë lekë ose 98 % e planit të periudhës, një realizim në masën 99.7 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar. Krahësuar me 12 mujorin 2024, u mblodhën rreth 44 miliardë lekë ose 6.2 % më shumë. Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2025 arritën në rreth 801.7 miliardë lekë, me një realizim në masën 97.2 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 96.4 përqind të planit vjetor të ndryshuar përmes Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025. Krahësuar me vitin 2024, shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 10 përqind më të larta ose rreth 73.1 miliardë lekë më shumë.

► LEXO MË SHUMË

përgjegjshmërisë së të gjitha strukturave doganore, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe avancimi i mëtejshëm i proceseve integruese, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes dhe zgjerimit të sistemeve inteligjente dhe teknologjive moderne, me qëllim rritjen e eficiencës, transparencës dhe kontrollit në proceset doganore, si dhe rritjes së të ardhurave buxhetore përmes luftës ndaj informalitetit dhe evazionit.

MINISTRI MALAJ TAKOHET ME HOMOLOGUN POLAK, DISKUTIME MBI ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK



mëtejshëm të marrdhënieve ekonomike, në kuadër edhe të

Ministri i Financave, Petrit Malaj, zhvilloi një vizitë zyrtare në Poloni, ku u takua me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë të Polonisë, z. Andrzej Domański, me të cilin bisedoi mbi ecurinë e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve. Dy ministrat shprehën interesin e përbashkët për forcimin e



MINISTRI I FINANCËVE TAKOHET ME MINISTRIN E DELEGUAR PËR TREGTINË E JASHTME DHE ATRAKTIVITETIN EKONOMIK TË FRANCËS

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim zyrtar me Ministrin e Deleguar për Tregtinë e Jashtme dhe Atraktivitetin Ekonomik të qeverisë së Francës, Nicolas Forissier. Gjatë këtij takimi, palët diskutuan mbi ecurinë e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe forcimit të mëtejshëm të tij në të ardhmen, me fokus në integrimin evropian, zhvillimin e qëndrueshëm dhe nxitjen e investimeve dypalëshe. Ministri Malaj vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme që qeveria



PREZANTOHET DREJTORI I RI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE, BESMIR BEJA

Përgjithshëm të Doganave, Besmir Beja, i cili merr detyrën duke zëvendësuar Gent Gazheli. Gjatë prezantimit u vlerësua kontributi i z. Gazheli në drejtimin e administratës doganore, si dhe u theksua rëndësia e vazhdimësisë institucionale dhe forcimit të mëtejshëm të rolit të Doganave në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit. Drejtori i ri, Beja, theksoi se prioritetet kryesore të punës së tij do të jenë rritja e angazhimit dhe

► LEXO MË SHUMË



ZHVILLOHET ANKANDI I INSTRUMENTIT OBLIGACIONE 15-VJEÇARE, KËRKESË E LARTË NGA TREGU

Ministria e Financave shënoi një tjetër sukses të rëndësishëm në tregun e brendshëm të titujve qeveritarë, duke zhvilluar më 2 shkurt 2026 ankandin për obligacionet 15-vjeçare. Me një shumë të shpallur prej 2 miliardë lekësh dhe kërkesa që arritën në 6.05 miliardë lekë, ky ankand u mbulua 3.02 herë, duke reflektuar besimin e lartë të investorëve në stabilitetin financiar të vendit. Norma e interesit prej 5.67% dhe pjesëmarrja e gjerë nga bankat, fondet e pensioneve, fondet e investimit, individët dhe institucionet financiare e konfirmojnë atraktivitetin e titujve afatgjatë të qeverisë. Obligacionet 15-vjeçare, të prezantuara për herë të parë në vitin 2021, po konsolidohen si një alternativë e fuqishme për investorët me horizonte të gjata, duke dëshmuar performancën e suksesshme të ankandeve të qeverisë dhe rolin e tyre në forcimin e financave publike.

► LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ TAKOHET ME DREJTORIN GLOBAL TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE PËR ZHVILLIMIN URBAN, FINANCAT VENDORE, TURIZMIN

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim Drejtorin Global të Grupit të Bankës Botërore për Zhvillimin Urban, Financat Vendore, Turizmin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive, Ming Zhang, si dhe ekipin e Turizmit (PIUTD), në fokus të të cilit ishte bashkëpunimi potencial në fushën e turizmit. Gjatë këtij takimi, palët diskutuan mbi zgjerimin e portofolit

investues, mbështetjen për projektet prioritare dhe rolin kyç të turizmit në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ministri Malaj vlerësoi se partneriteti me Grupin e Bankës Botërore mbetet thelbësor për të orientuar investimet drejt projekteve me ndikim afatgjatë dhe për të forcuar kapacitetet institucionale. Qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për të shfrytëzuar potencialin e plotë të turizmit shqiptar, duke e kthyer atë në një motor të qëndrueshëm zhvillimi dhe mirëqenieje për vend

► LEXO MË SHUMË